



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Kompania Regjionale e Mbeturinave/ Regional waste Company/
Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada



KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ
Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/325-025

Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Pastërtia" Sh.A.Ferizaj bazuar në Nenet 8, 10 paragrafi 2.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-121, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Nenin 16 të Statutit të Kompanisë shpall:

K O N K U R S

Për vende të punës:

Nr. i referencës se pozitive të punës:

Nr - 1761/22

- Dy (2) Mekanik

Përgjegjësi mbikqyrëse: Jo

Raportimi: Udhëheqësve të lëmive përkatës

Orari i plotë i punës: Po

Kohëzgjatja e emërimit, Në kohë të caktuar/ Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit

Koeficientet: Në harmoni me politikat zhvillimore të Kompanisë

Vendi i punës: Ferizaj

Dokumentet e nevojshme:

- Aplikacionin për punësim;
- CV-ja;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmia për kualifikim;
- Dëshminë që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Diplomën e Shkollës së Mesme.

Përshkrimi i vendit të punës dhe përvoja e punës:

Mekanik:

Punon në servisimin dhe riparimin e të gjitha llojeve të automjeteve, teston dhe kontrollon rregullësinë për mbajtje në gjendje të rregulltë pune të automjeteve, teston dhe provon rregullësinë e punës së motorit, ndërruesit, boshtit rrotullues, alternatorit, frejt, përquesit, lyrjen e motorit, pastrimin e filterave. Kryen punët dhe detyrat e punës sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë dhe Kryeshefit Ekzekutiv. Për punën e vetë është përgjegjës ndaj udhëheqësit të drejtëpërdrejtë dhe Kryeshefit Ekzekutiv të ndërmarrjes.

Përvoja e punës: Së paku një (1) vite përvoj pune.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aplikacioni mund të merret në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj, Rr."Enver Topalli" Nr.47 Ferizaj, ku edhe bëhet dorëzimi i Aplikacionit së bashku me dokumantacionin e kërkuar, apo mund të shkarkohet edhe në web-faqen e Kompanisë: www.pastertia.com.

Afati i konkursit për aplikim është i hapur 17 ditë kalendarik nga dita e publikimit në web-faqen e Kompanisë si dhe në shtypin ditor, duke filluar nga data **20.04.2022 deri 06.05.2022 u 15:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni numrin e tel. 0290/325-025.